

VENDIM
Nr. 428, datë 3.6.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, shtohet emërtesa “Agjencia Shtetërore për Shpronësim”.
- b) Lidhja nr. 6/8, që përmendet në pikën 9/8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- c) Lidhja nr. 9/1, që përmendet në pikën 12/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga fondet e miratuara, përkatësisht, për administratën tatimore qendrore, sistemin e arsimit parauniversitar dhe Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 6/8

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	20.000
Zv/drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	15.000
Drejtor kabineti Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme Drejtor i drejtorisë rajonale	III-a	1	15.000
Këshilltar në kabinet Përgjegjës/Shef sektori në njësitë teknike	III-a/1	1	14.000

të përmbajtjes apo njësitë mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme Drejtore drejtorie në drejtoritë rajonale			
Inspektor në njësinë përgjegjëse për kontrollin e specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	III-a/1	1	14.000
Përgjegjës/Shef sektori/Zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë Inspektor i auditit të brendshëm Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	III-b	1 ose 2	12.000
Përgjegjës zyre në Task Forcë	III-b	1 ose 2	17.000
Inspektor i dytë Specialist në drejtorinë e përgjithshme Inspektor hetimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale Specialist në njësitë e përmbajtjes dhe në njësitë juridike në drejtoritë rajonale	IV-a	1 ose 2 ose 3	12.000
Specialist në drejtorinë e përgjithshme Inspektor hetimi Inspektor Specialist në drejtoritë rajonale	IV-b	1 ose 2 ose 3	10.000
Specialist	IV-c	1 ose 2 ose 3	5.000
Sekretar në drejtorinë e përgjithshme	IV-b	1 ose 2 ose 3	5.000
Sekretar në drejtoritë rajonale	IV-c	1 ose 2 ose 3	5.000

Lidhja nr. 9/1

KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS, SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË DREJTORITË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, SI DHE SHITESA E KUALIFIKIMIT

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHITESA E KUALIFIKIMIT
Drejtore i drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar	III-a/1	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Drejtore i zyrave vendore të arsimit parauniversitar. Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	III-b	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-a	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-a	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Specialist në zyrat vendore të arsimit	IV-b	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40%

parauniversitar			Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
-----------------	--	--	--

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.